



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 87/2012
Prishtinë, më 05.12.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala dhe Fazile Bekteshi – MZHE; Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja – INDEP dhe Florije Mehmeti - KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari – Tha se dje shterëm debatin për shqyrtim në parim, në lidhje me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, të cilin e kemi hartuar ne si Komision. Ai tha se duke marrë parasysh që ne kemi inkorporuar të gjitha propozimet tona në projektligj, atëherë po i përfshijmë edhe propozimet e Qeverisë, të dërguara me mendimin e saj dhe pastaj në Komision i shqyrtojmë së bashku me të gjithë aktorët tjerë, në veçanti me ekspertizën e Komisionit Evropian.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim, Projektligji nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, përfshirë edhe mendimin e Qeverisë.

Po ashtu, Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale.
2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, raportuese, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Fikrim Damka- anëtarë.
3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t’i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.
4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit